



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

EKSTRAKTI PROCESVERBALIT

të mbledhjes së dytë të Komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara, mbajtur më 08.10.2019, e cila filloi në orën 13:15.

Në mbledhje morën pjesë: **Fatime Demolli - Mustafa**, kryesuese, **Mehreme Llumnica**, **Ramadan Salihu**, **Gyltene Retkoceri**, **Jeton Tanhasi**, **Ermira Shabani**, **Armend Ademi**, **Premtime Preniqi**, koordinatore e Njesisë për të drejtat e njeriut, dhe **Berat Cakaj**, interpretues.

Të pranishëm ishin: përfaqësuesit e Komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara nga Komuna e Kaçanikut: **Antigona Axhani - Baftijaj**, **Mirlinda Hysa**, **Artan Mezraja**, **Fiknete Krasniqi**, **Edita Shehu** dhe **Argjenta Axhani**.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Fatime Demolli - Mustafa**, kryesuese.

Ajo tha se çështjen e parë që dua ta diskutojmë është kërkesa e një nëne, e cila e ka fëmijën me Sindrom Doun, e cila jeton në Matiçan, ndërsa fëmija vijon në kopshtin "Gëzimi Ynë" e që është afër 10 km larg vendbanimit, por kopshtin më të afërt e ka kopshtin "Botanika". Është viti i tretë që aplikon në kopshtin "Botanika", por vazhdimisht i thonë se nuk kemi vend. Ajo ka aplikuar vitin e kaluar edhe në IP "Gëzimi Ynë" dhe informatat që janë marr nga ky kopsht janë se vitin e kaluar me rastin e aplikimit, nuk e ka dëshmuar me dokumente të nevojshme që fëmijën e ka me Sindrom Doun, por këtë vit i ka sjellë të gjitha dokumentet e nevojshme dhe i është pranuar fëmija në çerdhe.

Andaj, kërkoj të diskutojmë si Komitet se si të veprojmë tutje, në mënyrë që t'ia mundësojmë që të vijojë në kopshtin më të afërt, e që është "Botanikën", të cilin nuk e ka më larg se 5 minuta nga shtëpia.

Gyltene Retkoceri sugjeroi që të diskutohet kjo çështje me drejtorin/drejtoreshën e kopshtit "Botanika".

Ermira Shabani tha se fëmija për të cilin bëhet fjalë merr shërbime terapeutike te ne, për problemet që i ka pasur dhe që po vazhdojnë ende lidhur me regjistrimin në kopshtin "Botanika", kam biseduar me kolegët, kopshti "Botanika" është kopsht me bazë në komunitet, ne kur e kemi pasur një rast tjetër me kopshtin "Shkronjat", që është në lagjen "Arbëria" i cili është kopsht me bazë në komunitet, kur kemi shkuar për një problem tjetër që ka pasur me fëmijën, neve na është paraqitur një vendim i Komunës, që i përket lirimit prej pagesës për fëmijët me

aftësi të kufizuara. Ne nuk kemi mundur ta sigurojmë një kopje të atij vendimi, por vetë drejtoresha e kopshtit na ka paraqitur një Vendim të Komunës, ku aty nuk parashihet që fëmijët me aftësi të kufizuara janë të liruar prej pagesës së kopshtit. Tash "Botanika" është kopsht me bazë në komunitet, ndoshta duhet me qartësuar edhe këtë çështjen e pagesës, se edhe nëse bëhet e mundshme me u regjistruar, ka me qenë problem kjo çështja e pagesës, por vetëm të sigurohemi se a ekziston ai vendim, nga ka ardhur, kush e ka përgatitur dhe mbi çfarë legjislacioni është bazuar.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, u shpreh se me sa kam unë njohuri me ligjin, sa i përket edukimit para univerzitare, fëmijët me aftësi të kufizuara janë të liruar prej pagesave. Sipas Udhëzimit administrativ të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara janë të liruar nga pagesa. Besoj se atë udhëzim administrativ e kanë edhe kopshtet me bazë në komunitet, edhe kopshtet publike, përveç kopshteve jo publike. Tash nëse vlen Udhëzimi administrativ dhe ligji njëjtë edhe për ato kopshte me bazë në komunitet, nuk do të duhej të paguanin. Me sa kam unë njohuri, në kopshtin "Shkronjat" ndodhet një fëmijë me Sindrom dhe ai është i liruar nga pagesa. Nëse ai është i liruar nga pagesa, pse nuk lirohet edhe ky që dëshiron me aplikua në kopshtin "Botanika".

Gyltene Retkoceri pyeti për fëmijën që është në kopshtin "Shkronjat" se a e ka asistentin.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, tha se nuk e ka asistentin, por edukatorja merret me këtë fëmijë.

Ajo tha se me Premtimen e ka diskutuar çështjen dhe Premtimja e ka ngritur çështjen në Drejtori të Arsimit dhe ata i kanë thënë Drejtorja e Arsimit nuk i mbikëqyrë kopshtet me bazë në komunitet, andaj nuk janë përgjegjësi e DAK-së, kështu që mbetet në përgjegjësin e Kabinetit të Kryetarit. Nuk e di a mundet Ardiana me na ndihmuar në këtë aspekt, për ta gjetur Vendimin e kopshteve me bazë në komunitet.

Premtime Preniqi tha se zyrtarja e Drejtorisë së Arsimit e konfirmoi edhe një herë se nuk kanë mbikëqyrje në kopshtet me bazë në komunitet, mos të flasim që stafin e pranojnë burimet njerëzore, e në anën tjetër fëmijët i pranon Këshilli i prindërve. Sa i përket këtij rasti për këtë fëmijë, të dy prindërit janë të papunë, këtij fëmije i takon pa pagesë, por e habitshme është pse nuk po e pranojnë.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, tha se duhet të marrin vendim të shkojmë të bisedojmë me drejtorinë e kopshtit "Botanika" dhe t'i drejtohem Kabinetit të Kryetarit.

Ramadan Salihu theksoi se me sa po e kuptoj unë, këtu janë dy çështje, çështja juridike është e dy akteve, Udhëzimit administrativ dhe Vendimit. Ekziston ajo hierarkia juridike se cili dokument duhet t'i nënshtrohet tjetrit, d.m.th. Udhëzimi administrativ nëse është prej Ministrisë, është ma i madh, edhe është akti tjetër, akti diskriminues mospranimi i një PAK në institucion parashkollor, pa marrë parasysh a është institucion privat apo publik, ky është diskriminim, por pa pasur informata konkrete kështu që duhet me biseduar me institucionin kontestimor, d.m.th. kopshtin "Botanika" përgjegjësit, se ku qëndron problemi, pastaj me informatë të saktë të vazhdohet tutje.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, tha se po i dërgojmë E-mail drejtoreshës së çerdhes "Botanika", duke ju futur të gjithë anëtarët e Komitetit sisi, për një takim, vetëm ta caktojnë kohën që ju konvenon të gjithë anëtarëve që me qenë korrekt në kohë dhe me qenë pjesëmarrës. Çështja e dytë është Programi vjetor i punës së Komitetit, i cili ka qenë për vitin 2018, duhet me ia ndërruar vitin, me bërë 2019/2020. Unë mendoj sot me diskutuar me anëtarët e rinj të Komitetit se a pajtohen, a e miratojnë këtë program të punës një vjeçare.

Mehreme Llumnica propozoi që të jetë edhe monitorimi i Planit të veprimit, siç e kemi edhe synim ose si pikë e veçantë, se ka shumë fusha, atë e kemi punuar, iniciuar dhe gati skadon afati trevjeçar që ka qenë deri 2019 e me mundur me e shtyrë.

Te shënimi i ditës ndërkombëtare te PAK, a mundem me shtuar diçka, apo me përcaktuar ndonjë organizim të përbashkët te shënimi në Komunë, ndonjë prezentim, ndonjë hulumtim që kemi me bërë, ndonjë pikë.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese tha se tash e kemi 3 dhjetorin.

Premtime Preniqi tha se për PAK është e kufizuar, e kanë të përcaktuar nga 1 tetorit ka filluar kjo, mundësitë e barabarta.

Mehreme Llumnica tha se 3 dhjetori është Dita Ndërkombëtare e Aftësive të Kufizuar, për këtë po them a kemi ndonjë aktivitet të përcaktuar, apo duhet ne me planifikuar ndonjë organizim.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, shprehi mendimin se me rëndësi është me u miratuar ky plan, pastaj ndërhyjmë në plan.

Ermira Shabani theksoi se puna e Komitetit pasqyrohet, publikohet në ueb-faqe të Komunës, por kam menduar se PAK a mund të gjinden lehtë, se mund të hasin në vështirësi këta persona. Ndoshta kish qenë mirë me hapur një faqe në Facebook, ideja është me u dëgjuar zëri dhe me i informua qytetarët, qëllimi im i propozimit është se ndoshta kish qenë një hap që na ofron më shumë me qytetarë, me komunitetin të cilin po e përfaqësojmë.

Premtime Preniqi theksoi se mundeni me e hapur një faqe në fb. dhe me menaxhuar gjithë grupi, ose prej një administratori, cili do që është i lirë, dhe atij i dërgohen të dhënat dhe konsultoheni se çka me postuar.

Mehreme Llumnica shprehu mendimin se është ueb-faqja e Komunës dhe aty e kemi hapësirën, përveç raporteve çka do që kemi konkrete, madhore. Sa herë kemi nevojë janë të gatshëm ata me i postuar, te Facebook. Përveç administratorit, është mirë pak me u mirëmbajtur, se po keqpërdoren rrjetet sociale, por për me u bërë më aktuale dhe me u prezantuar më shumë puna e Komitetit. Unë kisha mendua me pasur edhe emisione të drejtpërdrejta nëpër media, me qenë një përfaqësues i Komitetit.

Premtime Preniqi tha se nëse del një faqe në Facebook edhe mos me publikuar në ndërkohë asgjë, mundeni mi publiku mbledhjet e rregullta dhe rendin e ditës, takimet që i mbani me drejtori, një fotografi të rastit e publikoni, në tjetrën anë është e mira p.sh. të njëjtën kohë mundet me dhënë komente njerëzit, munden me ju dhënë ide të tjerët dhe ata e kuptojnë që qenka edhe një komitet konsultativ i PAK dhe ajo me qenë faqe informuese.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, u shpreh e pajtimit me Ermirën, me propozimin që me hapur një faqe në fb. Nëse mundesh Ermira me e hapur si faqe, është mirë të gjithë anëtarët me pasur pasvordin dhe me mundur me u kyçur se çka po dëshirojnë me postuar.

Ermira Shabani tha se pajtohem që ta hapi një faqe, por më duket e ka mënyrën se si funksionon kjo hapja e faqes, është e atillë që nëse dëshiron ndonjë anëtar me postua diçka, në njëfarë mënyre duhet aprovimi i të gjithë administratorëve. Unë po e hapi një faqe, pastaj të gjithë anëtarët janë të kyçur, munden me postuar dhe në të njëjtën kohë, të gjithë jemi të informuar se mundemi mu rrezikua me postua të njëjtin lajm apo të njëjtin aktivitet.

Armend Ademi theksoi se prej mandatit të kaluar gjithmonë mbledhjet tona janë publikuar në ueb-faqe të Komunës. Sa i përket mungesës time në takim, është e vërtetë se nga shtatori kam filluar me punuar në Shoqatën Kosovare për të Shurdhër, jam asistent në Zyrën për shqyrtimin e

ligjeve, hulumtimit, grumbullimit të informacioneve, kështu që nga ora 8:00 - 16:00 jam në punë ndërsa nga ora 17:00 deri në orët e vona jam në zyrën e Shoqatës në Prishtinë. Unë kisha propozuar, brenda mundësive takimet me i lënë ditëve të premte, prej orës 14:00, se ditët tjera është e pamundur me marrë pjesë në takime.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, tha se në bazë të diskutimeve në këtë takim, u vendos:

- Të shkojmë në kopshtin "Botanika", që ta diskutojmë çështjen e fëmijës Shkëmb Vrajolli;
- Të hapet një E-mail, një faqe në Facebook, në mënyrë t'i publikojmë të tjerat;
- Të miratohet Plani vjetor i punës 2019/2020.

Premtime Preniqi i përshëndeti të pranishmit dhe u dëshiroi mirëseardhje përfaqësuesve të Komitetit konsultativ për PAK të Komunës së Kaçanikut.

U bë edhe prezantimi i anëtarëve të Komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Prishtinës dhe anëtarëve të Komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara nga Komuna e Kaçanikut.

Lidhur me punën që e bën ky Komiteti në Komunën e Prishtinës, që është mandati i dytë në këtë vit, fjalën e mori kryesuesja e Komitetit konsultativ për PAK, zonja Fatime Demolli- Mustafa.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese e komitetit i përshëndeti të pranishmit e cila tha se komiteti ka filluar punën që nga viti 2016 me 5 anëtarë, ndërsa në këtë vit ky komitet ka gjithësej 7 anëtar. Është e paraparë që brenda vitit të mbahen afër 5 takime të rregullta të Komitetit konsultativ, ku në ato takime ne i vendosim prioritetet tutje çka do të bëjmë dhe prej takimeve të rregullta ne i vizitojmë drejtorët e drejtorive varësisht prej çështjes që del në pah dhe çështjeve që i kemi prioritet si komitet.

Mehreme Llumnica tha është i mirëseardhur takimi i përbashkët dhe për shkëmbim përvojash dhe më e mira është se na presin sfida të përbashkëta gjatë punës që kemi hasur gjatë viteve të kaluara, ku dhe do të nihemi për së afërmi edhe për angazhimet tona edhe sfidat që kemi hasur. Ne si komitet jemi zgjedhur me konkurs, kemi qenë 8 anëtarë, ku prej tyre kemi qenë të përfshirë përfaqësues të 5 llojeve të aftësive të kufizuara, si ato me dëmtime fizike, dëmtime shqisore, sidrom doun, autizmit dhe të shurdhërve. Kjo është një prioritet se ne jemi zëri i këtyre qytetarëve që gjithmonë do të avokojmë dhe do të jemi urë lidhëse dhe këshilldhënës të Komunës për përmirësimin dhe krijimin e mundësive të barabarta të personave me aftësi të klufizuara. Ne i kemi mbajtur takime të rregullta brenda vitit, njashtu edhe takimet me dikasteret e caktuar, me përfaqësues të zyrtarëve si të nivelit qendror dhe ati lokal.

Gjithashtu një bashkëpunim shumë të mirë kemi pasur me ish- drejtorin e Drejtorisë së Administratës, z. Muhedin Nushi, tani Nënkyetar i Komunës. Një bashkëpunim të mirë kemi pasur edhe me përfaqësuesit e OJQ-ve të ndryshme të shoqërisë civile, përfaqësues përgjegjës të OJQ-ve që merren me aftësi të kufizuara edhe me institucionet shkollore edukative.

Po ashtu një përkrahje kemi pasur edhe nga donatorët e jashtëm, jo si komitet por si OJQ- "Hendikos ", që ka organizuar trajnime për ngritjen e kapaciteteve të stafit të anëtarëve të komitetit. Si anëtar i këtij komiteti kemi marrë pjesë edhe në hartimin e Planit të veprimit për aftësinë e kufizuar në komunën e Prishtinës dhe në bashkëpunim edhe me përfaqësuesit e OJQ-ve lokale që veprojnë në komunën e Prishtinës. Ky plan tre vjeçar është miratuar në Kuvendin e Komunës, ku si prioritet janë marrë sugjerimet e vet qytetarëve me aftësi të kufizuara por edhe të

organizatave të ndryshme. Në mungesë të një vije buxhetore për realizimin e disa kërkesave që dalin nga ky komitet, por prapë se prapë kemi arritur që me Njësinë e burimeve njerëzore në Komunën e Prishtinës që të merren disa iniciativa si për punësim, për një qasje sa më të lehtë në trafik etj.

Premtimi Preniqi tha se ky komitet në mandatin e kaluar tre vjeçar e ka pasur një punë të rëndë për arsye se ka qenë mandati i parë, faktikisht gjithçka ka filluar prej tyre, mirëpo me të vërtetë prej themelimit të këtij Komiteti shumë gjëra kanë lëvizë. Mund të konstatojmë se, një përkrahje shumë e madhe ka qenë edhe prej z. Muhedin Nushi, ish- drejtor i Drejtorisë së Administratës i cili ka bërë të mundur një qasje sa më të lehtë në objektin e komunës për personat me aftësi të kufizuar. Po ashtu edhe në veb-faqe të Komunës kanë arritur që të publikohen të gjitha të dhënat se çka ka punuar ky komitet, si dhe është edhe një Plan i veprimit të cilin e kemi deri në vitin 2020 dhe se ky komitet është në monitorim të atij plani.

Ramadan Salihu tha më vjen mirë që edhe një komunë e Kosovës e ka themeluar Komitetin konsultativ sikurse edhe ne dhe uroj që kështu të vepronë edhe komunat tjera në tërë Republikën e Kosovës. Ne jemi një komitet konsultativ, e kemi rolin vetëm si këshillënës dhe nuk kemi ndonjë rol vendimmarrës apo të ngjashme. Kjo ka qenë sfida jonë e parë, sepse nga dëshira për t'ju ndihmuar personave me aftësi të kufizuar ne kemi qenë të sfiduar se si të vepronim andaj në këtë drejtim ne kemi krijuar Udhërrëfyesin për punë të Komitetit e pastaj Planin e veprimit, Planin e punës, Raportimin për punësim etj. Ne jemi të gatshëm me ju ofruar eksperiencën tonë dhe presim nga ju me na ofruar dijen tuaj dhe të gjeturat tuaja në komunën tuaj që së bashku të bëjmë një koordinim të mëtejshëm.

Sa i përket punës së komitetit kemi hasur në aprovim dhe në rezistencë të institucioneve komunale. Aprovimi ka qenë në aspektet sociale të trajtimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuar siç janë : biletat e transportit, beneficionet në shëndetësi, aspektet tatimore etj. Mirëpo kemi hasur në sfida serioze të punësimit i tyre që ne si komitet kemi vërejt dhe e kemi eksperiencën se kjo është kërkesa kryesore e secilit individ, prandaj këtu kemi hasur në rezistencë sepse autoritetet janë arsyetuar se mungon ai legjislacioni i cili e lejon atë procedurën e rekrutimit për të pranuar me përparësi apo ndonjë bonus për këtë kategori të këtyre personave.

Ne kemi konsideruar se kjo nuk qëndron sepse e kemi konsultuar mjaftë mirë legjislacionin për këtë aspekt dhe e kemi gjetur se vërtetë nuk ka një pengës ligjore për punësimin e këtyre personave ndoshta edhe mund të ndihmojë ndonjë Udhëzim administrativ i cili i ndërlikohet Ligjin për shërbyesit civil që ka qenë atëherë Ligjin e punës dhe Ligjin për aftësim dhe riaftësim profesional dhe punësim të këtyre personave.

Premtimi Preniqi tha se është për keqardhje çështja e punësimit në tërë Kosovën, mungesa e vendeve të lira edhe për tjerët po shkakton problemin, e kur flasim për grupet e marginalizuara që shtohet edhe dy-tre fish por si Komitet kanë arritur qëllimin edhe me bërë një pasus gjatë hapjes së konkurseve në Komunën e Prishtinës mu shënuar që inkurajojnë për me aplikuar edhe këta persona. Gjithashtu ky komitet ka arritur që këta persona të lirohen nga pagesat në transportin publik, pastaj për tatimet të cilat shkojnë prej nivelit Qendror mu liruar prej pagesës, mandej nëpër organizata apo firmat të cilat aplikojnë në Komunë të Prishtinës për ndonjë tender me pasur si obligative mi punësuar edhe këtë kategori të këtyre personave etj.

Artan Mezraja tha se ideja e themelimit të këtij komiteti ka qenë para shumë kohësh, pra ka munguar iniciativa e institucioneve publike në këtë rast Komunës së Kaçanikut për ta themeluar.

Ideator për themelimin e këtij komiteti ishte "Handikosi" dhe takimin e parë e kemi pasur më 16 shtator të këtij viti.

Komiteti jonë nuk ka asnjë anëtarë të personave me aftësi të kufizuar, pasi që nuk ka pasur gatishmëri nga ana e atyre personave për t'iu bashkangjitur konkursit.

Ky komitet ka 7 anëtarë të profesioneve të ndryshme dhe se qëllimi i këtij takimi ishte që të merren disa modele nga komiteti i komunës së Prishtinës, pra mi pa mundësitë e bashkëveprimit të bashkëpunimit të kauzës të çështjes së aftësisë së kufizuar në politikat qendrore të Republikës së Kosovës.

Premtime Preniqi sugjeroi që komiteti i komunës suaj ta ketë një bashkëpunim të ngushtë me z. Vedat, koordinator i të drejtave të njeriut në Komunës e Kaçanikut, për dhënjen e ndihmës në aspektin logjistik etj.

Mehreme Llumnica sugjeroi që ky komitet i Komunës së Kaçanikut ta ketë një bashkëpunim sa më të ngushtë me përfaqësues të OJQ-ve se janë shumë përgjegjës dhe me anëtarë të të gjitha llojeve të aftësive të kufizuara sepse ata më së miri i dinë dhe kanë nevojë mi prek gjërat konkrete. Si shembull konkret mori Komisionin për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Prishtinës e cila tha se njëra prej anëtarëve të këtij komisioni jam edhe un që e përfaqësoj shoqërinë civile.

Mirlinda Hysa tha se disa nga anëtarët e komitetit më herët kanë qenë pjesë të shoqërisë civile dhe në mënyrë të vazhdueshme kanë lobu për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuar, pra konsideroj që edhe tani e kemi mbështetjen e tyre.. Sa i përket z. Vedat, ne do të kontaktojmë me ate, por ne paraprakisht dëshironim që nga komiteti juaj të marrin disa provoja që për neve do të jenë shumë të mirëseardhura.

Mehreme Llumnica pyeti se gjatë takimit të parë kush ka qenë prezentë prej komunës me ju .

Artan Mezraja tha se është e rendit ligjor mbledhjen me e hapur kryesuesi i Kuvendit Komunal. Sa i përket angazhimit të këtyre personave në ndonjë aktivitet si shembull mori zgjedhjet e 6 tetorit e cila tha se Komisioni i zgjedhjeve në këto zgjidhje e ka refuzuar listën prej 10 anëtarëve të personave me aftësi të kufizuar për me punuar si komisioner, edhe përkundër një Memorandumi të mirëkuptimit që e ka pas me "Hendikosin".

Artan Mezraja po ashtu tha se do të ishte mirë që edhe ne ta kemi një kopje të këtij Plani të punës, pra ta kemi si model si një pikë orientuese si me punuar.

Ramadan Salihu tha se po shihet se si mungesë e këtij komisioni të juaj është se asnjë anëtar nuk është nga personave ma aftësi të kufizuar.

Artan Mezraja tha se sa i përket përzgjedhjes së anëtarëve të komitetit prezent ka qenë përfaqësuesja e "Hendikosit" edhe e ka pas të pa mundur me qenë pjesë e komitetit. Si kriter për me qenë pjesë e këtij komiteti është dashtë të jetë person me kualifikim, me diplomë univerzitare, kriter i cili është vendosur nga kompetentët e Komunës së Kaçanikut.

Premtime Preniqi i falënderoj përfaqësuesit e Komitetit të Kaçanikut që ishin prezent në këtë takim të përbashkët.

Procesmbajtësja:
Shyhrete Islami

Mbledhja përfundoi në orën 15:00.

Kryesuesja e Komitetit
Fatime Demolli - Mustafa



Faqe 6 nga 6